



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2823/prot.

3

Urë Vajguore, më 14.10.2024

VENDIM

Nr. 51 Datë 14. 10.2024

“Për miratimin për shtesë aktivitetesh tek Aktiviteti 3.1.1 “Zgjerim i shërbimeve të Qendrës Multifunkionale të Bashkisë”, i parashikur në Planin Social 2024-2026 i miratuar në KB me Nr. 48 dt. 26.12.2023”

Këshilli i Bashkisë Dimal, në mbledhjen e tij të datës 14.10.2024 mbi bazën e materialit të paraqitur nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Prokurimeve, Shërbimeve Mbështetëse Marrëdhënien me Publikun, Ndihma Ekonomike dhe PAK pranë Bashkisë Dimal, në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 24 “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pika 1; Ligjin Nr: 121 dt. 21.11.2016 “ Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, kreu “neni 16; VKM 518, dt. 04.09.2018 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial, Kriteret, Procedurat për Përfitimim e Tyre dhe Masën e Shumës për Shpenzime Personale për Përfituesit e Shërbimit të Organizuar” Kreu II “Shërbimet e Kujdesit Shoqëror Komunitar e Rezidencial”, pika 11, b, i,ii. Për IPSH, Relacionit nr. 2759 prot, datë 23.09.2024, nga Sektori i Qendrës Komunitare Multifunkionale “Për kujdestarë në shërbimin Social”. Gjithshtu mbështetur dhe në Planin Social të Bashkisë Dimal miratuar në Këshillim Bashkiak me Nr. 48 dt. 26.12.2023 në të cilim kemi përcaktuar Qëllimin Strategjik 3: Diversifikimi i shërbimeve sociale ekzistuese për t’ju përgjigjur efektivisht nevojave të individëve në situatë vulnerabël në territorin e Bashkisë.

VENDOSI :

Me 14 vota PRO, nga 14 Këshilltarë prezentë :

1. Të miratojë vendimin për shtesë aktivitetesh tek Aktiviteti 3.1.1 “Zgjerim i shërbimeve të Qendrës Multifunkionale të Bashkisë”, i parashikur në Planin Social 2024-2026 i miratuar në KB me Nr. 48 dt. 26.12.2023”, përkatësishtë tek: Objektivi Specifik 1. Shërbimet sociale komunitare mundësojnë adresimin efektiv të rasteve emergjente, si dhe rintegrimin, përkujdesin, mbrojtjen e fuqizimin e individëve që i kanë të nevojshme këto shërbime.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë .
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, sipas përcaktimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit 139/2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore “, i ndryshuar.

**KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK
AVDULLA SALILLARI**



